



KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI – SUHAREKË

Nr. Protokollit	01 / 2022
Vendi i takimit:	Salla e Bordit të Drejtorëve
Datë:	25.02.2022

PROCESVERBAL

Nga takimi i Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive “KKS” – Suharekë të paraparë sipas Udhëzimit Administrativ të nënshkruar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Nr-27/2012, dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Nr-03/2012, për themelimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKS).

Takimi filloi në ora 10.00

Në mungesë të Kryetarit, takimin e kryesoi Nënkyetaria e Komunës znj. Mihrije Suka.

Në takim morën pjesë :

Afrim Sylaj - Komandant në Stacionin Policor në Therandë
Halim Shehu - përfaqësues i Komunitetit Islam
Mikel Sopi - përfaqësues i Komunitetit Katolik
Enver Shabani - Drejtoria e shërbimeve publike, siguri dhe emergjencë
Fetije Bytyqi - përfaqësuese e EVSB-së
Remzi Bajselmani - Drejtor i Drejtorisë së arsimit
Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore
Albestrim Rexhepi - përfaqësues i FSK-së
Drilon Zyba - përfaqësues i KLSP-së
Adem Derguti - Kryetar i KPAK-së
Rozeta Jahaj - përfaqësuese e DJQ-ë
Refki Zogaj - përfaqësues i komunitetit të biznesit
Erolinda Zenelaj - përfaqësuese e mediave lokale
Xheladin Sadikaj - përfaqësues i zyrës KKK-së
Qëndresa Bftjaraj - përfaqësuese e KPAK-së
Myrvete Shala - përfaqësuese e Shqiptarëve
Denis Sofra - Kryesues i KK-së dhe përfaqësues i KA-li
Zekë Berisha - përfaqësues i Romëve
Nazim Shabanaj - përfaqësues i Egjiptasve

Në takim munguan:

Rend dite

1. Miratimi Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë në territorin e Komunës;
3. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimi i planit operativ për përdorimin e masave mbrojtës për mbrojtje nga përhapja e COVID-19;
4. Identifikimi i brengave të qytetarëve lidhur me sigurinë publike;

Nënkryetaria - përshëndet të pranishmit dhe ju uron suksese anëtarëve të rinjë. I njofton me rendin e ditës dhe e hedh në votim.

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Nënkryetaria - a ka vërejtje në procesverbal? Nuk ka.

Aprovohet

Pika 2. Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë në territorin e Komunës;

Nënkryetaria - për këtë pikë, ia jep fjalën Komandantit të policisë z. Afrim Sylaj.

Afrim Sylaj - përshëndet të pranishmit. Në vitin 2022, pra këtë muaj kemi një situatë të qetë me disa incidente të cilat nuk ndikojnë me sigurinë e përgjithshme. Në këtë muaj kemi përpiluar një plan për vitin 2022, ku parashihet: shtimi i aktiviteteve policore; Zbatimi i planeve operative siq janë: shtimi i patrullimit policor afër lokacioneve ku ka incidente, shtimi i pikave të kontrollit në lokacione të ndryshme, siguria në trafik, parandalimi i aksidenteve, masat edukative, sanksionimi i kundërvajtësve në trafik dhe mbajtja e rendit dhe qetësisë publike në përgjithësi. Pikë tjetër si objektivi është siguria në shkolla dhe afër tyre.

Ju njoftoj që në vitin 2021 nuk kemi pas asnjë rast të vrasjeve. Në këtë muaj kemi pas disa lloj vjedhjesh, ku disa janë në proces të hetimeve dhe disa janë zbuluar. Kemi pas një dukuri negative, dukuria e narkotikëve. Dhe ju e dini që është kry një operacion i gjerë ku ka rezultuar me një sasi të madhe të konfiskuar të llojit mariuahanë. Dukuri tjetër shqetësuese ka qenë dhuna në familje në vitin 2021. Kemi pas një numër të madh të rasteve me lëndime trupore në vitin 2021. Prishja e rendit dhe qetësisë publike, ku si identifikim e kemi një kafiteri në rr. "Hajdin Berisha", e cila vazhdimisht e shqetëson një lagje, dhe Komuna është mire të marrë masa për këtë. Shqetësim tjetër janë edhe qentë endacak.

Breng e fshatit Mushtisht është mungesa e stacionit të autobusëve në fshat.

Habibe Bytyqi - përshëndet të pranishmit. Për këtë vit potencoj për disa çështje, se keni plan dhe objektiva. Dua të di prej policisë, a ka ndonjë planifikim për rastet e dhunës në familje, ndonjë aktivitet apo prioritet.

Afrim Sylaj - Janë parapa ligjëratat nëpër shkollë me tema të veçanta për rastet e dhunës në familje. Gjithë ashtu në stacionin policor, Kfori Italian ka ndërtuar një dhomë të miqësisë për mi trajtu këto raste.

Habibe Bytyqi - ju sugjeroj që të kërkonit nga niveli qendror, që policët që merren me dhunën në familje me pas një trajnim për këto raste se si ti trajtojnë ato.

Afrim Sylaj - kemi trajnime që mbahen në Vushtrri në vazhdimësi, gjithëashtu trajnime që i mbajmë brenda stacionit të policisë.

Refki Zogaj - përshëndet të pranishmit. Si ekziston mundësia në zonën industriale në Shirokë,që të vihen disa shenja mbi zhvillimin e shpejtësisë? Dhe kisha pas dëshirë që policia nën atë zone ta kontrolloj shpejtësinë.

Afrim Sylaj - në vendet ku nuk ekziston sinjalizimi është problem shqiptimi i gjobave.

Nënkryetarja - për pjesën e shenjave të sinjalizimit është kompetencë drejtoria e urbanizmit. Ne e kemi një projekt ku shenjat janë duke u vendos.

Drilon Zyba - kam bërë një kërkesë zyrtare për një përgjigje prej policisë.Si KLSH ende s'kam marrë përgjigje.Këkesa jonë ka qenë që një here në jav me qen një polic në zyrën tone.

Afrim Sylaj - përgjigjen do ta kthejmë dhe besoj që do ta realizojmë.

Avni Bytyqi - pasi u diskutu mjaft për këtë pikë duhet të dalim me një rekomandim.

Rekomandim: Të vazhdohet bashkëpunimi mes qytetarëve dhe policisë si dhe Komunës për çështjen e trajtimit të sigurisë së qytetarëve.

Nënkryetarja - e hedh në votim rekomandimin.

Aprovohet

Pika 3. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkollë dhe zbatimin e planit operativ për përdorimin e masave mbrojtëse për mbrojtje nga përhapja e COVID-19;

Nënkryetarja - për këtë pikë ia jep fjalën drejtorit të Arsimit z. Remzi Bajselamnit.

Remzi Bajselmani - situata është e mirë nëpër shkollë. Ne gjatë javës kemi pas vetëm një shkollë onllajn, sepse kanë qenë të infektuar 4 mësuesit sot kam komunikuar me drejtorin, gjendja është e mirë dhe nga e hëna mësimi kthehet në normalitet. Sa i përket sigurisë gjendja është e mirë. Sipas përvojës që kemi dhe situatave që ndodhin është kryesisht muaji mars,dhe kërkojmë që të rritet bashkëpunimi veçanërisht për muajin mars. Gjithashtu shqetësues janë qentë endacak.

Nënkryetarja - qentë endacak jo vetëm në Komunën tonë por në gjithë Kosovën janë problem. Disa here kemi pas projekte por nuk ka pas efekt.

Enver Shabani - jep sqarime sa i përket qeneve endacak.

Rekomandim: Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me gjithë drejtorët e shkollave,ta zbatojnë planin operativ për parandalimin e përhapjes së COVID-19.

Nënkryetarja - e hedh në votim rekomandimin.

Aprovohet

Pika 4. Identifikimi i brengave të qytetarëve lidhur me sigurinë publike;

Nënkryetarja - hap debatin për këtë pikë.

Avni Bytyqi - tri shqetësime veq u ngriten. Pikërisht për këtë është vendosur kjo pikë dhe ju bëj thirrje të gjithëve ju të pranishëm që të na njoftoni rreth çështjes së sigurisë në aspektin e përgjithshëm të Komunës tonë për çdo shqetësim.

Xhevahir Hasanaj - përshëndet të pranishmit Lëvizjet të cilat i bëjmë në këtë zonë në aktivitete të ndryshme,gjithmonë jemi në koordinim me zyrtarët Komunal dhe policinë. Sa i përket shqetësimit aktual,nuk ka diçka për tu shqetësuar, për shkak se akteret e të gjitha elementeve të sigurisë operojnë në Kosovë dhe janë duke e përcjellë situatën.

Refki Zogaj - sa i përket zonës industriale, së bashku me organet e Komunës dhe Kryetarin jemi duke punuar dhe tash do të jetë jetë sinjalizimi që nga dalja e autostradës,në mënyrë që maunat mos të hyjnë në qytet,por në transit dhe të hyjnë në zonë industriale.

Nënkryetarja - kjo që thatë është një iniciativë e mire,por është mire ta mbani një takim me ekspertë të urbanizmit për sinjalizimet. Sa i përket ambientit, ka qenë një ndër prioritetet e Kryetarit dhe është punuar shumë.

Enver Shabani - çdo vit ka aksion për pastrim në gjithë territorin e Komunës së Suharekës. Investimet në Zonën Industriale kanë qenë në vazhdimësi dhe janë rreth 10 milion investime. Në fund të marsit të këtij viti Kryetari ka shpall një mega aksion, ku do të dalin të gjithë vullnetar, punëtor nxënës etj.

Nënkryetarja - premtimi i Kryetarit ka qenë që në Komunën e Suharekës të ketë një kompani Publike ,dhe jemi në procedure të themelimit të kësaj kompanie,e cila kryesisht do të merret me rregullimin e rrugëve, për shkak se procedurat me prokurim po zgjasin shumë.

Enver Shabani - jep sqarime rreth themelimit të Kompanisë Publike.

Afrim Sylaj - duke pa rëndësinë në Zonën Industriale,ne si polici kemi diskutuar që do të ishte i mirëseardhur funksionimi i njësisë së zjarrfikëseve brenda zonës.

Enver Shabani - është e mire si kërkesë dhe si propozim,por duhet ti shohim procedurat. Gjithë ashtu dua të cek, që gjendja për parandalimin e zjarreve nuk është e mire në asnjë kompani dhe në asnjë shkollë.

Avni Bytyqi - propozimet që u thane,ne kemi mi implementu në të ardhmen. Jeni të mirëseardhur të jepni propozime edhe me shkrim.

Nënkryetarja mbyll takimin dhe falemnderon të pranishmit për pjesmarrjen.

Takimi përfundoi: 11:00

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj